



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇËSHTJEVE JURILDIKE
SEKTORI I SEKRETARI-ARKIVIT

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Prefekti i Qarkut Fier Nr.Prot. 7031, Data 12.07.2023
Shkurtimi i lëndës Fthim pergjigje 4221

Për trajtim nga:	<u>B. Jelo Hevelo</u>
(struktura të tjera të ngarkuara)	<u>B. Jelo Hevelo</u>
Me porosi:	<u>14.07.2023</u>

Afati: normal (7 ditë) Prioritet (3 ditë) Urgjent (Brenda ditës) Pa afat/ për dijemi Tjetër ___ ditë

Data 14.07.2023 Nr. Prot 4221/1

Marrë në dorëzim: _____ Nënshkrimi: (TITULLARI) _____

Kalon për trajtim (struktura): _____ Nënshkrimi _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____ Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____ Nënshkrimi _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____ Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim specialisti: _____ Nënshkrimi _____

Me porosinë: _____

Trajtim i materialit përfunduar më: _____, Specialisti

Trajtim i materialit pranuar më: _____, Specialisti



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 703/1 Prot.

Fier, më 12 . 07 . 2023

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr. 65, dhe Nr. 66, të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 29.06.2023.

BASHKISË ROSKOVEC
KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC

Roskovec

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 4221 prot. datë 30.06.2023, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 703 prot. datë 06.07.2023, bazuar në ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 8, shkronja “a”, neni 16, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3, pika 2, shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 29.06.2023, shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes Nr. 9, datë 29.06.2023, të mbajtur në Librin e Procesverbalit të Mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec me Nr. 112, prot. datë 10.01.2023, si dhe dokumentacionin plotësues të vendimeve, shprehemi si më poshtë:

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 65, datë 29.06.2023, “Për miratimin e dokumentit të parë të PBA 2024-2026” shoqëruar nga projektvendimi Nr. 65, datë 23.06.2023, protokolluar me Nr. 4095 prot. datë 23.06.2023, relacioni shpjegues Nr. 4095/1 prot. datë 23.06.2023, procesverbali i dëgjësës publike Nr. 3, datë 23.05.2023, procesverbali i dëgjësës publike Nr. 4, datë 24.05.2023, procesverbali i dëgjësës publike Nr. 5, datë 25.05.2023, procesverbali i dëgjësës publike Nr. 6, datë 26.05.2023, procesverbali i dëgjësës publike Nr. 7, datë 26.05.2023, Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, pika 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 41 pika 1; Ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes vendore” neni 6 shkronja “ç”, neni 36 pika 8 ; Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” (i ndryshuar) neni 26, Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore” si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 6, datë 28.02.2023, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026” pika 13.

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 66, datë 29.06.2023, “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2023” shoqëruar nga projektvendimi Nr. 66, datë 23.06.2023, protokolluar me Nr. 4096 prot. datë 23.06.2023, relacioni shpjegues Nr.

4096/1 prot. datë 23.06.2023, është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1/b, dhe 1.3/c, neni 54, shkronja “dh”; Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 6, neni 15, neni 44; Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 6, shkronja “d”, neni 10, neni 22, pika 2, neni 23, pika 4, neni 27, neni 28; si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Lefter Shehaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4211 Prot.

Roskovec, më 30.06 2023

VENDIM

NR 58 .DATË 29.06.2023

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KONSTITUIMIT TË
KËSHILLIT BASHKIAK TË DATËS 14.06.2023”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 14.06.2023, në mbledhjen e Konstituimit të Këshillit Bashkiak .
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3882/1 Prot.

Roskovec, më 14 . 06 .2023

Procesverbal Nr.8

-I mbajtur sot, date 14.06.2023, ora 12³⁰, ne mbledhjen e pare te Keshillit te Bashkise Roskovec, te dale nga zgjedhjet vendore te dates 14 Maj 2023, per Konstituimin dhe zgjedhjen e organeve drejtuese dhe perfaqesuese te tij, me rend dite :

- 1 Konstituimi i Këshillit Bashkiak dhe zgjedhja e organeve drejtuese e përfaqësuese.
 - 1.1 Konstituim i Këshillit Bashkiak
 - a. Zgjedhja e komisionit të mandateve;
 - b. Verifikimi i mandateve dhe miratimi i mandateve të antarëve të Këshillit Bashkiak;
 - c. Betimi i këshilltarëve.
 - 1.2 Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Bashkiak
 - a. Paraqitja dhe prezantim i shkurtër i kandidatëve;
 - b. Zgjedhja e komisionit të votimit;
 - c. Përgatitja dhe procedurat e votimit;
 - d. Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Bashkiak;
 - 1.3 Zgjedhja e zëvendëskryetarit/rëve të Këshillit Bashkiak;
 - a. Miratimi me votim i numrit të zëvendëskryetarëve të Këshillit Bashkiak;
 - b. Paraqitja dhe prezantim i shkurtër i kandidatëve;
 - c. Përgatitja dhe procedurat e votimit;
 - d. Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e zëvendëskryetarit/rëve të këshillit bashkiak.
2. Ceremonia e marrjes-dorëzimit të detyrës së Kryetarit të Bashkisë.
 - a. Deklarimi i vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë .
 - b. Kryerja e betimit të Kryetarit të Bashkisë.
3. Zgjedhja e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkisë në Këshillin e Qarkut.

Ora e hapjes se mbledhjes: 12³⁰

Keshilltaret prezent: A.Plaka, E.Musko, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, Zh.Metushi, E.Kaçeli, N.Z eka, H.Hajdini, E.Toska, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, J.Begaj, A.Hoxha, V.Çepele, A.Pelo, S.Bibo, F.Feleqi.

Keshilltaret qe mungojne : Elmas Çepele dhe Pegiola Toro me arsye.

Prezent nga bashkia dhe te ftuar: Kryetarja e rizgjedhur M. Bufi, deputetet Taulant Balla, Baftjar Zeqaj, Prefekti i Qarkut Lefter Shehaj me perfaqesues te institucionit te tij, nenkryetari M. Goga si dhe disa qytetare.

Me plotesimin e kuoromit , mbledhja e sotme sipas ligjit hapet nga Sekretarja e Keshillit Bashkiak. Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 19 keshilltare. Sekretarja e keshillit hap mbledhjen duke falenderuar te gjitha pjesmarresit dhe anetareve te rinj te keshillit ju uron suksese.

Procedura e pare : Sekretarja lexon Vendimin e KQZ-se me Nr.583 date 24.05.2023, duke lexuar subjektet zgjedhore sipas mandateve dhe kandidatet fitues qe jane : “Bashke Fitojme”-1. Emels Xhaxhaj, 2. Dhurata Malka, 3. Jorgo Begaj, 4. Pegiola Toro, 5. Amarildo Hoxha, 6. Viola Çepele, 7. Antueno Pelo. “Partia Socialiste e Shqiperise”-1. Afrim Plaka, 2. Esmeralda Musko, 3. Rrapi Hazizi, 4. Floriana Hoxha, 5. Leksi Goga, 6. Ermira Buzi, 7. Zhaku Metushi, 8. Elisabeta Kaçeli, 9. Nazmi Zeka, 10. Habibe Hajdini, 11. Elmas Çepele, 12. Elisabeta Toska. “Partia Drejtasi, Integrim dhe Unitet-Sara Bibo, dhe “Partia Balli Kombetar”-Fredri Feleqi. Sekretarja sqaron se keta jane emrat fitues te dale nga zgjedhjet e 14 Maj 2023. Vendimi hyn ne fuqi menjehere sipas percaktimit ne shkrese. Sekretarja prezanton dhe te ftuarit me radhe : Deputetet e Kuvendit Z. Taulant Balla dhe Z. Baftjar Zeqaj, Prefekti i Qarkut Fier Z. Lefter Shehaj.

-Sipas ligjit ftojme Z. Nazmi Zeka si me i moshuari i antareve te keshillit per te drejtuar mbledhjen, deri ne momentin e zgjedhjes se Kryetarit te Keshillit. Z. Nazmi Zeka merr fjalën dhe vazhdon me zgjedhjen e Komisionit te Mandateve. Votim i hapur. Leksi propozon Ermira Buzi dhe Habibe Hajdini. Dhurata Malka propozon Antueno Pelo. Bien dakort per komisionin e mandateve unanim 19 keshilltare. Komisioni i mandateve do te zgjedh kryetar, zv/kryetar dhe sekretar. Te tre emrat e propozuar mblidhen per te ndare detyrat dhe per verifikimin e mandateve dhe miratimi i mandateve te antareve te keshillit bashkiak. Komisioni harton procesverbalin. I mbajtur sot me 14.06.2023 komisioni i verifikimit te mandateve lexon procesverbalin. Ermira Buzi-kryetare komisioni, Habibe Hajdini-sekretare komisioni, Antueno Pelo-zv/kryetar komisioni. Komisioni i mandateve deklaroi se keshilli i bashkise u konstitua dhe vazhdon leximin e betimit, dhe listen e anetareve te keshillit sipas subjekteve. Z. Nazmi fton keshilltaret te ngrihen ne kembe. Hidhet ne votim raporti i verifikimit te mandateve, unanim votojne pro 19 keshilltare. Z. Nazmi lexon betimin dhe orienton te gjitha keshilltaret per te bere betimin. Betohen. Sekretarja e keshillit fton te gjitha keshilltaret te nenshkruajne individualisht formulën e betimit.

-Nazmi Zeka vazhdon fjalimin per zgjedhjen e Kryetarit te Keshillit dhe fton anetaret per propozim nga subjektet perkatese qe do garojne si kandidat per kryetar keshilli. Leksi propozon Afrim Plaka, Dhurata propozon Fredri Feleqi. Keshilltaret bien dakort me propozimet e mesiperme. Ftojme qe te zgjidhen me votim te hapur anetaret e komisionit te votimit. Leksi propozon Znj. Floriana Hoxha dhe Z. Zhaku Metushi per anetar komisioni. Dhurata propozon Z. Amarildo Hoxha per anetar komisioni. Keshilltaret bien dakort. Floriana Hoxha kryetare komisioni, Amarildo Hoxha zv/kryetar, Zhaku Metushi sekretar. Vazhdojne procedurat per procesin e votimit. Kryetarja e komisionit shpjegon procesin e votimit dhe therret keshilltaret me radhe per te votuar ne menyre te fshehte. Mbyllet procesi i votimit nga te gjitha anetaret e keshillit dhe komisioni i votimit harton procesverbalin. Hapet kutia dhe kryetarja e komisionit lexon fletet e votimit duke i treguar nga anetaret per transparence. Numerohen fletet nje e nga nje. 19 flete votimi nga 19 anetare qe votuan, 19 flete te vlefshme. Afrim Plaka 12 vota, Fredri Feleqi 7 vota. Kryetar i Keshillit fiton me shumice votash z. Afrim Plaka, me 12 vota nga votimi i fshehte. Komisioni i votimit harton procesverbalin dhe kryetarja e komisionit e lexon. Z. Zeka fton kryetarin e sapo emeruar z. Afrim

Plaka te drejtoje mbledhjen ne vijimesi.Z.Afrim Plaka merr fjalen dhe falenderon te gjithë pjesmarresit.Merr detyren menjehere.Kryetari i keshillit vazhdon me rendin e dites sipas pikes nr.2. Lexon vendimin e Gjykates per vertetimin e mandatit te Znj.Majlinda Bufi dhe fton kryetaren znj.M.Bufi te bej betimin.Kryetari i sapo emeruar lexon betimin dhe Kryetarja e bashkise ben betimin.Me pas Kryetarja e bashkise ben nenshkrimin e aktit te betimit dhe Kryetari i keshillit i vendos shiritin simbol te kryetarit te bashkise.Kryetarja merr fjalen dhe ben falenderimet per secilin,dhe shpreh angazhimin e saj per 4 vitet ne vazhdim.Kryetari i keshillit fton Prefektin e Qarkut Fier z.Lefter Shehaj per te bere fjalimin e tij.Z.Lefter Shehaj merr fjalen dhe falenderon pjesmarresit.

- Zgjedhja e zevendes kryetareve te keshillit bashkiak.

Kryetari i keshillit fton anetaret te propozojne per sa emra per nenkryetar keshilli.Fton sesa nenkryetar do te kete keshilli dhe me votim te hapur propozojne te jene 2 nenkryetar.Bien dakort per 2 nenkryetar.Leksi Goga propozon znj.Ermira Buzi.Dhurata Malka propozon z.Fredi Feleqi.Zhaku Metushi propozon znj.Sara Bibo.Do mblidhet serish komisioni i meparshem per te ndjekur mbarevajtjen e procesit te votimit per 2 emrat me me shume vota.Kryetarja e komisionit sqaron fleten e votimit i cili permban 3 emra dhe fleta eshte e vlefshme nese eshte votuar 1 emer ose 2 emra.Nese jane votuar 3 emra fleta e votimit quhet e pavlefshme.Anetaret e keshillit vijojne procesin e votimit.Mbyllet procesi i votimit,fillon procesi i numerimit te votave.19 anetare votuan-19 flete votimi.Si rezultat i numerimit te votave :Ermira Buzi 12 vota,Sara Bibo 12 vota,Fredi Feleqi 7 vota.Komisioni verifikon fletet e votimit dhe jane 19 flete votimi te vlefshme.Komisioni ploteson procesverbalin dhe ben leximin e tij.I mbajtur sot me date 14.06.2023 rezulton se Ermira Buzi me 12 vota dhe Sara Bibo me 12 vota,te cilat shpallen zevendes kryetare te keshillit bashkiak,me shumice votash nga votimi i fshehte.

- Zgjedhja e perfaqesuesve te keshillit bashkiak ne Keshillin e Qarkut.

Kryetari i keshillit fton Sekretaren e keshillit te lexoje shkresen e Prefektures,sipas ligjit ku eshte percaktuar numri,bashkia Roskovec duhet te kete perfaqesues ne Qarkun Fier 4 anetar.Kryetarja eshte automatikisht,ngelen per propozim 3 anetar nga keshilli.

Leksi Goga propozon ne emer te grupit te PS :1.Leksi Goga,2.Esmeralda Musko,3.Rrapi Hazizi.Dhurata Malka ne emer te grupit te Bashke Fitojme propozon :1.Amarildo Hoxha,2.Antueno Pelo,3.Dhurata Malka.Ne fleten e votimit jane listuar 6 emrat e propozuar duke rene dakort unanimisht per to.Kryetari i keshillit shprehu qe ne votimin e kandidateve duhet te ruhet barazia gjinore.Votimi do te jete i fshehte.Komisioni i votimit ndjek proceduren.Kryetarja e komisionit sqaron procesin e votimit ku nga 6 kandidate duhet te votohen vetem 3 anetar.Fillon procesi i votimit.Pasi mbaron procesi i votimit,hapet kutia e votimit dhe fillon numerimi i fleteve.Gjate kesaj kohe 6 anetaret e keshillit te subjektit bashke fitojme u larguan nga mbledhja.Vetem zv.kryetari i komisionit Amarildo Hoxha ndenji deri ne fund te procesit te numerimit.Kryetarja e komisionit Florjana Hoxha ploteson procesverbalin dhe e lexon ate.I mbajtur sot me date 14.06.2023 rezulton se Leksi Goga me 12 vota,Esmeralda Musko 12 vota,Rrapi Hazizi 12 vota ,Amarildo Hoxha 7 vota,Antueno Pelo 6 vota,Dhurata Malka 7 vota.Me shumice votash prej 12 votash perfaqesuesit e keshillit ne keshillin e Qarkut Fier jane :1.Leksi Goga,2.Esmeralda Musko,3.Rrapi Hazizi.Kryetari i Keshillit Afrim Plaka mbyll mbledhjen e keshillit.

Mbajti procesverbalin

As.Sek.keshillit

Paola Goga



Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4242 Prot.

Roskovec, më 30, 06 2023

VENDIM

NR. 59. DATË 29. 06. 2023

**“MBI MIRATIMIN E MANDATEVE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË
ROSKOVEC”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 49 pika 1,2,3, neni 50, neni 54 gërma j; si dhe raportit të Komisionit të Mandateve, Këshilli i Bashkisë;

VENDOSI :

1- Miratimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Roskovec si më poshtë :

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Subjekti
1.	Elmas Hasan Çepele	Partia Socialiste
2.	Pegiola Pëllumb Toro	Bashkë Fitojmë

2- Ngarkohet Sekretaria e Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.

3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4213 Prot.

Roskovec, më 30, 06 2023

VENDIM

NR 60 DATË 29, 06 2023

PËR

KRIJIMIN E KOMISIONEVE TË PËRHERËSHME TË KËSHILLIT.

-Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015"Për Vetëqeverisjen vendore," neni 54 gërma a,
Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

Miratimin e Komisioneve të Përherëshme të Këshillit si më poshtë :

I. KOMISIONI I MANDATEVE DHE I RREGULLOREVE

- | | | |
|------------------|---|------------|
| 1.Ermira Buzi | - | Kryetar |
| 2.Antueno Pelo | - | Zv.kryetar |
| 3.Habibe Hajdini | - | Sekretar |

2.KOMISIONI EKONOMIK DHE I BUXHETIT

- | | | |
|------------------|---|------------|
| 1.Floriana Hoxha | - | Kryetar |
| 2.Viola Çepele | - | Zv.kryetar |
| 3.Elmaz Çepele | - | Anëtar |
| 4.Leksi Goga | - | |
| 5.Amarildo Hoxha | - | |

3.KOMISIONI PËR ZHVILLIMIN URBANISTIK DHE NDËRTIMET

- | | | |
|-------------------|---|------------|
| 1.Rrapi Hazizi | - | Kryetar |
| 2.Dhurata Malka | - | Zv.kryetar |
| 3.Elmaz Çepele | - | Anëtar |
| 4.Pegiola Toro | - | |
| 5.Esmeralda Musko | - | |

4.KOMISIONI PËR PROBLEMET E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCËS

- | | |
|--------------------|-------------|
| 1.Fredi Feleqi | -Kryetar |
| 2.Elisabeta Toska | -Zv.kryetar |
| 3.Emels Xhaxhaj | - Anëtar |
| 4.Elizabeta Kaçeli | - |
| 5.Rrapi Hazizi | - |

5.KOMISIONI PËR ARSIMIN,KULTURËN,RINISË DHE SPORTEVE

- | | |
|--------------------|-------------|
| 1.Elizabeta Kaçeli | -Kryetar |
| 2.Jorgo Begaj | -Zv.kryetar |
| 3.Ermira Buzi | - Anëtar |
| 4.Dhurata Malka | - |
| 5.Nazmi Zeka | - |

6.KOMISIONI PËR MBROJTJEN DHE SHËNDETIN PUBLIK

- | | |
|--------------------|-------------|
| 1.Antueno Pelo | -Kryetar |
| 2.Esmeralda Musko | -Zv.kryetar |
| 3.Zhaku Metushi | -Anëtar |
| 4.Sara Bibo Qamili | - |
| 5.Fredi Feleqi | - |

7.KOMISIONI PËR PROBLEMET JURIDIKE DHE TË RENDIT

- | | |
|--------------------|-------------|
| 1.Amarildo Hoxha | -Kryetar |
| 2.Sara Bibo Qamili | -Zv.kryetar |
| 3.Antueno Pelo | -Anëtar |
| 4.Elizabeta Kaçeli | - |
| 5.Nazmi Zeka | - |

8.KOMISIONI PËR PROBLEMET E BUJQËSISË E MJEDISIT

- | | |
|-------------------|-------------|
| 1.Emels Xhaxhaj | -Kryetar |
| 2.Leksi Goga | -Zv.kryetar |
| 3.Elisabeta Toska | -Anëtar |
| 4.Fredi Feleqi | - |
| 5.Ermira Buzi | - |

9.KOMISIONI PËR BARAZINË GJINORE DHE CËSHTJEVE SOCIALE

- | | |
|------------------|--------------|
| 1.Habibe Hajdini | - Kryetar |
| 2.Pegiola Toro | - Zv.kryetar |
| 3.Leksi Goga | - Anëtar |

4.Viola Çepele -
5.Zhaku Metushi -

- Ngarkohen Komisionet e Përherëshme të Këshillit dhe Sekretaria e Këshilli me zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 42/14 prot

Roskovec , më 30.06.2023

VENDIM

Nr. 61 datë 29/06/2023

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR
DERI 6% PËR PERIUdhËN 1-31 MAJ 2023**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8 pika 2,9,24, të nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë dhe”, në pikën 2, 3, 6, 9, dhe 10 të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019“Për përcaktimin e procedurave,të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmëse konomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”,VKB Nr.3 datë 27.01.2023 “Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike,nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën për vitin 2023”,Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin **Maj 2023**, në total **23 (njëzetë e tre)** familje me fond total prej **98558 (nëntëdhjetë e tetëmijë e pesëqind e pesëdhjet e tetë)** lekë.Konkretisht:

PËR BANORËT E QENDRËS SË BASHKISË ROSKOVEC

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Maj 2023,**4 (katër)** familje me një fond **10648 (dhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e tetë)** lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE STRUM

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Maj 2023,**6 (gjashtë)** familje me një fond **28018 (njëzetë e tetë mijë e tetëmbëdhjetë)** lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KUMAN

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Maj 2023, **5 (pesë)** familje me një fond **24296 (njëzetë e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë)** lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KURJAN

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Maj 2023, **8 (tetë)** familje me një fond **35596 (tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë)** lekë.

- Ngarkohet sektori i Financës dhe sektori i Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka



Bashkia Roskovec
Maj 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës	Shuma
1	Agron Osmën Çanta		1	Familje në nevojë	2178
2	Skender Hysni Malko		1	Familje në nevojë	2178
3	Bukuroshe Sali Çepele		1	Familje në nevojë	3146
4	Selvi Rystem Çepele		1	Familje në nevojë	3146
	Shuma				10648

Mbyllet me nr rendor 4(katër)



Njësia Administrative Strum

Maj 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Agroseda Arben Musko		2	Familje në nevojë	5940
2	Arta Bilbil Rroko		3	Familje në nevojë	7920
3	Astrit Shefqet Dogani		3	Familje në nevojë	3703
4	Nurie Selman Hazizi		2	Familje në nevojë	3703
5	Rajmonda Halim Ziu		3	Familje në nevojë	4574
6	Drita Mehmet Cepele		1	Familje në nevojë	2178
	SHUMA				28018

Mbyllet me numrin rendor 6(gjashtë)

KRYETAR KESHILLI

Afrim Plaka



Njësia Administrative Kuman
Maj 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	ndihmes	Shuma
1	Eduard Riza Hoxha		3	Familje në nevojë	4792
2	Eugerta Medin Satëri		3	Familje në nevojë	7920
3	Klaudja Viktor Metaj		2	Familje në nevojë	5940
4	Yllka Shefqet Refitaj		1	Familje në nevojë	2178
5	Aishe Jonus Akulli		1	Familje në nevojë	3466
5	Shuma				24296

Mbyllet me nr rendor 5(pesë)

KRYETAR KËSHILLI
Afrim Plaka



Njësia Administrative Kurjan
Maj 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës	Shuma
1	Ramadan Gani Koronaj		1	Familje në nevojë	5720
2	Donika Hysni Lika		1	Familje në nevojë	3466
3	Gëzim Hysen Goricani		1	Familje në nevojë	3146
4	Ludjana Namik Shabanaj		3	Familje në nevojë	7920
5	Yzedin Shaban Panahori		2	Familje në nevojë	3703
6	Turand Laver Lika		3	Familje në nevojë	4792
7	Donika Vexhi Kuka		2	Familje në nevojë	3146
8	Petrit Riza Shabanaj		2	Familje në nevojë	3703
	Shuma				35596

Mbyllet me nr rendor 8 (tetë)

KRYETAR KËSHILLI

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4718 Prot.

Roskovec, më 30.06 2023

VENDIM

NR 62 . DATË 29.06 .2023

***“PËR CAKTIMIN E VENDQËNDRIMIT PROVIZOR TË SHITËSVE AMBULANT NË
QYTETIN E ROSKOVECIT”***

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”i ndryshuar; të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar; të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, Këshilli i Bashkisë;

VENDOSI:

1. Caktimin e një vendqëndrimi të dedikuar për shitësit ambulant në qytetin e Roskovecit.

- Vendimi paraqet caktimin e një vend depozitimi të përcaktuar për shitësit ambulant, i cili do të jetë në rrugën e Kurjanit, afër Raiffeisen Bank me një sipërfaqe rreth 50m2 sipas planvendosjes bashkëngjitur.
- Shitësit ambulant do të tregëtojnë produktet e tyre gjatë ditëve të javës përveç dites së djelë.
- Ambjenti duhet të pastrohet pas çdo dite nga vet tregëtarët sipas tezgës së tyre.
- Sistemimi dhe vijëzimi i tij do të realizohet nga Ndërmarrja e Shërbimeve të Mirëmbajtjes, Roskovec.

2. Ngarkohet Drejtoria e IMT-së dhe Policia Bashkiake, Ndërmarrja e Shërbimeve të Mirëmbajtjes dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4816 prot.

Roskovec, më. 30.06.2023

VENDIM

NR 63 .DATË 29.06.2023

**“PËR ELEMENIMIN E PAGESËS SË TAKSËS SË NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË
PËR NDËRTIMIN E BANESËS ME KOSTO TË ULËT (objekti social 6-katësh)”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 24, Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i përditësuar, neni 46, pika 3, VKB-së Nr.98, datë 30.12.2020 “Për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit ‘Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e një banese me kosto të ulët në Bashkinë Roskovec”, Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Bashkisë Roskovec dhe Entit Kombëtar të Banesave, protokolluar në institucionin tonë me Nr.113 prot, datë 07.01.2021, pika 3, neni 3, shkronja d; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Eleminimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimin e banesës me kosto të ulët e objektit social me 6-kate.
2. Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4217 Prot.

Roskovec, më 30, 06 2023

VENDIM

NR 64, DATË 29.06.2023

“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË KONSOLIDUAR TË ZBATIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2022”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44, të ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore” neni 51, të udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Këshilli i Bashkisë ,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2022, sipas materjalit të paraqitur, bashkëlidhur vendimit.
2. Ngarkohet Ekzekutivi i bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6218 Prot.

Roskovec, më 30.06 2023

VENDIM

NR. 65, DATË 29.06 2023

“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PARË TË PBA 2024-2026”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, të ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të ligjit Nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” , të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të Programimit Buxhetor Afatmesëm” të ndryshuar me udhëzimin Nr.7 datë 25.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të Programimit Buxhetor Afatmesëm”; të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026” si dhe materjaleve të sjella nga Drejtoria Ekonomike , Këshilli i Bashkisë ,

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentin e parë për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 për Bashkinë Roskovec dhe 2 njësitë shpenzuese në vartësi, sipas tabelave në formatet output dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë bashkëlidhur :
 - Tabelën 1 “Tavanet e Programeve Buxhetore”;
 - Tabelën 2 “Burimet Buxhetore”;
 - Tabelën 3-5 “Shpenzimet sipas kategorive ekonomike”;
 - Tabelën 4 “Shpenzimet sipas klasifikimit funksional”
 - Tabelën 4.1 “Shpenzimet sipas programeve”;
 - Tabelën 6 “Deklarata e politikës së programeve”;
 - Tabelën 7 “Shpenzime e produkteve të programeve”;
 - Tabelën 8 “Projektet e Investimeve”;
 - Tabelën 9 “Të dhënat bazë mbi programet”;

- Relacion shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (Shtojca 2,Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026).
- 2. Ngarkohet Ekzekutivi i bashkisë për zbatimin e këtij vendimi për vazhdimin e punës së mëtejshme të përgatitjes së PBA 2024-2026 sipas këtij dokumenti.
- 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4219 Prot.

Roskovec, më 30, 06 2023

V E N D I M

Nr. 66, datë 29/06 /2023

“ PËR MIRATIM FONDESH SHITESË NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2023”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar, neni 9 , pika 1.3 gërma c , neni 54 pika dh , të ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore“ neni 45 , të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar neni 44 , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, vendimit të Këshillit të Bashkisë , të VKB Nr.98 datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit , numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarjeve vartëse për vitin 2023” ,shkresës Nr.8321 prot.datë 08.05.2023 të MFE,si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoritë përkatëse të Bashkisë;Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- I. Mbështetur në shkresën Nr.8321 prot. datë 08.05.2023 të MFE, të miratohet shpërndarja e fondit Grant i Pakushtëzuar Specifik prej : **1,245,518 lekë** për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor (edukatoren), **192,000 lekë** për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor (punonjës mbështetës), **192,000 lekë** për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parauniversitar, **144,000 lekë** për rritjen e pagave për funksionin e Ujitja dhe Kullimi dhe **520,800 lekë** për rritjen e pagave për funksionin e Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi,si më poshtë vijonë :

Shtohet:

1. NJËSIA SHPENZUESE “BASHKIA ROSKOVEC”,KODI 2113001

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMËRTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Shuma	2023	2024
1	00	09120	1	600	Paga për arsimin parashkollor	1,060,000	1,060,000	0
2	00	09120	1	601	Sig. Shoq. për arsimin parashkollor	185,518	185,518	0
3	00	04240	1	600	Paga për Ujitje dhe Kullimi	120,000	120,000	0

4	00	04240	1	601	Sig. Shoq. për Ujitje dhe Kullimi	24,000	24,000	0
5	00	03280	1	600	Paga për Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi	450,000	450,000	0
6	00	03280	1	601	Sig. Shoq. Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi	70,800	70,800	0
SHUMA :						1,910,318	1,910,318	0

2. NJËSIA SHPENZUESE “NDËRMARJA E SHËRBIMEVE TË MIRËMBAJTJES”, KODI 2113002

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMËRTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Shuma	2023	2024
1	00	09120	1	600	Paga për arsimin parashkollor	160,000	160,000	0
2	00	09120	1	601	Sig. Shoq. për arsimin parashkollor	32,000	32,000	0
3	00	09230	1	600	Paga për Arsimi Parauniversitar	160,000	160,000	0
4	00	09230	1	601	Sig. Shoq. për Arsimi Parauniversitar	32,000	32,000	0
SHUMA:						384,000	384,000	0

II. Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Roskovec dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4870 Prot.

Roskovec, më 30, 06 2023

V E N D I M

Nr. 67, datë 29/06 /2023

“ PËR MIRATIM TË PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR VITIN 2023”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar, neni 9 , pika 1.3 , neni 54 pika dh , të ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore“ neni 45 , të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar neni 44 dhe 45 , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” , të VKB Nr.98 datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit , numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarjeve vartëse për vitin 2023” , si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoritë përkatëse të Bashkisë; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- I. Miratimin e fondit 6,318,510 lekë për shpenzime për mirëmbajtje “Për riparim të pjesshëm të shkollave nën administrim të bashkisë Roskovec”, me financim për vitin 2023 prej 1,200,000 lekë të përballohet nga fondi rezervë dhe 5,118,510 lekë financim për vitin 2024 nga fondi i shpenzimeve operative & mirëmbajtjes duke bërë ndryshimet përkatëse në PBA 2024-2026 për fazën e II.

1. NJËSIA SHPENZUESE “BASHKIA ROSKOVEC”, KODI 2113001

Shtohet:

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMËRTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Shuma	2023	2024
1	00	09120	5	602	Shpenzime operative & mirëmbajtjes për arsimin bazë	6,318,510	1,200,000	5,118,510
					SHUMA :	6,318,510	1,200,000	5,118,510

Pakësohet

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMËRTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Shuma	2023	2024
1	00	01110	5	609	Fondi rezervë dhe kontigjenca	1,200,000	1,200,000	0
					SHUMA:	1,200,000	1,200,000	0

II. Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Roskovec dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka

